


# Tregtia e jashtme e mallrave

## Tetor 2018

**Tiranë, më 19 Nëntor 2018:** Në Tetor 2018 eksportet e mallrave arritën vlerën 30 mld lekë, duke u rritur me 21,2 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe me 14,8 %, në krahasim me Shtator 2018. Importet e mallrave arritën vlerën 58 mld lekë, duke u rritur me 1,0 %, në krahasim me një vit më parë dhe me 14,0 %, në krahasim me Shtator 2018. Deficiti tregtar i këtij muaji është 28 mld lekë, duke u ulur me 14,2 %, krahasuar me Tetor 2017 dhe rritur me 13,1 %, në krahasim me Shtator 2018.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Në dhjetëmujorin e vitit 2018 eksportet e mallrave arritën vlerën 262 mld lekë, duke u rritur me 16,0 %, krahasuar me një vit më parë dhe importet e mallrave arritën vlerën 525 mld lekë, duke u rritur me 2,8 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 264 mld lekë, duke u ulur me 7,6 %, krahasuar me 2017.

**Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:**

Rritja vjetore e eksporteve prej 21,2 %, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +8,8 pikë përqindje, “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +4,0 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +3,1 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve ka ndikuar negativisht grupi: “Lëkurë dhe artikujt prej tyre” me -0,2 pikë përqindje.

**Fig.2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Tetor 2018**




Eksportet, gjatë këtij dhjetëmujori janë rritur me 16,0 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të eksporteve, janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +5,9 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +4,0 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me +2,7 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve ka ndikuar negativisht grupi: “Lëkurë dhe artikujt prej tyre” me -0,1 pikë përqindje.

**Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:**

Rritje vjetore e importeve prej 1,0 %, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me +1,2 pikë përqindje, “Prodhime druri dhe letre” me +0,8 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” dhe “Produkte kimike dhe plastike” me +0,4 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve ka ndikuar negativisht grupi: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -2,1 pikë përqindje.

**Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Tetor 2018**



Si dhjetëmujor, importet janë rritur me 2,8%, krahasuar me dhjetëmujorin 2017. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve, janë: “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me +1,3 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë”, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” dhe “Prodhime druri dhe letre” me +0,3 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve nuk ka ndikuar negativisht asnjë grup.

**Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere**


Në muajin Tetor 2018, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Tetor 2017 janë: Italia (3,5 %), Spanja (91,7 %) dhe Kosova (46,8 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe janë: Kina (-4,6 %), dhe Ukraina (-36,0 %).

Gjatë këtij dhjetëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (3,9 %), Kosova (27,5 %) dhe Spanja (66,7 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Kina (-35,6 %), Ukraina (-51,6 %) dhe Rusia (-57,6 %).

Në muajin Tetor 2018, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Tetor 2017 janë: Turqia (1,7 %), Kina (17,9 %) dhe Gjermania (3,4 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (-4,3 %), Rusia (-28,1 %) dhe Zvicra (-53,0 %).

Gjatë këtij dhjetëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Turqia (4,7 %), Greqia (3,2 %) dhe Kina (9,7 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Italia (-0,5 %), Gjermania (-3,7 %) dhe Zvicra (-27,7 %).

Fig.4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Tetor 2018



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE zënë 66,5 %, të gjithë tregtisë. Në Tetor 2018, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 76,1 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 61,5 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (33,5 %), Kina (6,4 %), Turqia (6,3 %) dhe Greqia (6,2%).

Shkëmbimet tregtare, për dhjetëmujorin 2018, me vendet e BE zënë 66,5 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Tetor 2018, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 76,3 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 61,6 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (34,5 %), Greqia (6,9 %), Gjermania (6,6 %) dhe Kina (6,1 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1		6,4	-336	42,0
2017		273	12,1			-353	
2016	01 - 16	16	-7,8	35	-1,0	-18	47,0
	02 - 16	18	-4,4	42	7,6	-24	42,0
	03 - 16	19	-12,7	47	5,6	-28	41,2
	04 - 16	21	1,7	52	19,0	-31	40,7
	05 - 16	21	-14,8	52	16,7	-31	39,6
	06 - 16	23	-6,4	52	6,2	-29	43,5
	07 - 16	23	-0,2	50	-4,5	-28	44,9
	08 - 16	16	6,9	47	15,9	-30	35,3
	09 - 16	21	0,9	48	9,3	-28	42,8
	10 - 16	22	7,3	50	-0,8	-28	43,5
	Janar - Tetor 16	199	-3,5	474	7,1	-275	41,9
2017	01 - 17	19	15,6	35	0,9	-16	53,8
	02 - 17	20	14,2	44	5,1	-24	45,7
	03 - 17	24	22,0	54	14,9	-30	43,8
	04 - 17	24	13,7	50	-3,9	-26	48,1
	05 - 17	24	18,2	56	7,4	-31	43,6
	06 - 17	23	-0,1	57	9,2	-34	39,7
	07 - 17	25	9,9	55	9,6	-30	45,1
	08 - 17	18	12,3	49	6,2	-31	37,4
	09 - 17	24	17,0	53	10,9	-29	45,1
	10 - 17	25	14,5	58	15,5	-33	43,1
	Janar - Tetor 17	226	13,5	511	7,8	-285	44,2
2018	01 - 18	24	24,5	45	27,5	-21	52,5
	02 - 18	24	18,8	46	4,4	-22	52,0
	03 - 18	27	14,6	55	2,5	-28	49,0
	04 - 18	27	11,3	53	5,2	-26	50,9
	05 - 18	30	24,3	57	2,1	-27	53,1
	06 - 18	27	18,1	54	-4,7	-27	49,2
	07 - 18	27	8,2	58	6,0	-31	46,0
	08 - 18	20	10,8	48	-2,3	-28	42,4
	09 - 18	26	8,9	51	-4,4	-25	51,4
	10 - 18	30	21,2	58	1,0	-28	51,7
	Janar - Tetor 18	269	16,0	525	9,0	-256	49,0

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milione lekë)

	Eksporte				Importe			
	Tetor 17	Tetor 18	Jan. - Tet. 2017	Jan. - Tet. 2018	Tetor 17	Tetor 18	Jan. - Tet. 2017	Jan. - Tet. 2018
<b>Vendet e BE-së</b>	<b>19.368</b>	<b>22.911</b>	<b>173.461</b>	<b>199.700</b>	<b>34.756</b>	<b>35.754</b>	<b>315.088</b>	<b>323.521</b>
Austri	146	190	1.331	1.490	922	539	5.615	5.565
Mbretëri e Bashkuar	24	312	345	1.009	545	530	4.364	4.852
Gjermani	909	1.151	9.055	11.333	4.126	4.265	42.099	40.535
Greqi	1.103	1.337	9.779	11.146	3.842	4.130	41.822	43.181
Itali	12.978	13.427	120.467	125.155	16.825	16.108	146.549	145.889
Spanjë	1.549	2.970	12.499	20.831	1.137	2.878	11.304	13.811
Kroaci	89	112	692	757	522	585	3.704	5.581
Të tjera të BE-së	2.570	3.412	19.294	27.980	6.838	6.719	59.631	64.107
Kinë	584	557	7.288	4.697	4.292	5.061	39.294	43.089
Kosovë	2.008	2.948	17.584	22.413	786	934	6.941	7.375
Maqedonia	747	757	7.167	7.239	875	882	7.180	7.904
Rusi	3	4	82	35	1.155	830	9.508	11.229
SHBA	277	388	2.367	4.312	676	909	7.352	7.617
Turqi	143	327	1.792	1.884	5.108	5.192	41.750	43.695
Ukrainë	37	24	418	202	351	501	2.742	2.483
Zvicër	9	32	970	2.838	1.434	674	10.072	7.277
Të tjera	1.645	2.140	14.465	18.263	8.116	7.412	70.787	70.937
<b>Gjithsej</b>	<b>24.822</b>	<b>30.087</b>	<b>225.595</b>	<b>261.583</b>	<b>57.549</b>	<b>58.151</b>	<b>510.713</b>	<b>525.127</b>

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milione lekë)

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Tetor 17	Tetor 18	Jan. - Tet. 2017	Jan. - Tet. 2018	Tetor 17	Tetor 18	Jan. - Tet. 2017	Jan. - Tet. 2018
<b>Gjithsej</b>	<b>24.822</b>	<b>30.087</b>	<b>225.595</b>	<b>261.583</b>	<b>57.549</b>	<b>58.151</b>	<b>510.713</b>	<b>525.127</b>
Ushqime, pije, duhan	3.640	3.931	24.034	26.264	8.753	8.738	88.050	89.006
Minerale, lëndë djegëse, en,el,	3.313	5.504	36.155	49.569	7.171	5.945	51.792	53.201
Produkte kimike dhe plastike	389	584	3.971	5.168	7.551	7.779	71.997	72.790
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	249	204	2.476	2.350	1.724	1.801	15.515	15.793
Prodhime druri dhe letre	816	994	6.604	7.458	2.094	2.542	19.551	20.954
Tekstile dhe këpucë	10.159	10.815	97.821	103.831	8.636	8.681	71.082	72.606
Materiale ndërtimi dhe metale	4.152	4.914	36.064	45.081	7.022	7.271	64.507	64.931
Makineri, pajisje dhe pj, këmb,	1.428	2.413	12.253	15.010	12.266	12.958	108.371	115.175
Të tjera	676	727	6.217	6.853	2.333	2.435	19,850	20.671

**Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë)**

	Itali		Kosovë		Spanjë		Gjermani	
	2017	2018	2017	2018	2017	2018	2017	2018
<b>Gjithsej</b>	<b>120.467</b>	<b>125.155</b>	<b>17.584</b>	<b>22.413</b>	<b>12.499</b>	<b>20.831</b>	<b>9.055</b>	<b>11.333</b>
Ushqim. pije duhan	6.687	6.604	2.264	2.251	641	1.080	1.187	1.194
Minerale. lëndë djegëse. ener. elek.	6.248	4.095	4.391	5.301	9.365	16.663	849	1.790
Produkte kimike dhe plastike	1.135	1.336	1.032	1.102	13	54	20	27
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	1.853	1.725	6	9	77	216	13	10
Prodhime druri dhe letre	4.664	5.223	352	394	5	287	86	129
Tekstile dhe këpucë	76.280	80.027	105	91	2.150	2.354	4.776	5.827
Materiale ndërtimi dhe metale	13.352	14.734	7.837	11.438	238	135	892	748
Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi	7.401	8.229	605	716	2	30	989	1.168
Të tjera	2.846	3.182	992	1.112	7	10	242	440

**Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë)**

	Itali		Turqi		Greqi		Kinë	
	2017	2018	2017	2018	2017	2018	2017	2018
<b>Gjithsej</b>	<b>146.549</b>	<b>145.889</b>	<b>41.750</b>	<b>43.695</b>	<b>41.822</b>	<b>43.181</b>	<b>39.294</b>	<b>43.089</b>
Ushqim. pije duhan	15.069	14.725	4.750	4.710	11.548	12.737	510	571
Minerale. lëndë djegëse. ener. elek.	13.639	10.446	1.392	659	6.366	6.780	7	7
Produkte kimike dhe plastike	15.393	15.498	6.001	6.698	6.663	6.383	3.958	4.116
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	12.025	12.176	303	269	67	49	626	637
Prodhime druri dhe letre	5.333	6.129	2.829	2.859	2.719	2.860	884	928
Tekstile dhe këpucë	35.258	35.252	13.058	13.800	3.257	3.123	9.140	8.699
Materiale ndërtimi dhe metale	16.497	17.550	5.078	6.433	7.710	7.371	5.139	5.717
Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi	28.346	29.201	6.410	6.213	2.027	2.386	14.765	18.149
Të tjera	4.989	4.911	1.930	2.055	1.465	1.491	4.264	4.266

# Përkufizime

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të rieksportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit, edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Mbretëria e Bashkuar, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

## Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(±) deri